



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Ekonominë dhe Financat*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.3.2022, ora 10:00

#### **Drejton mbledhjen:**

**Eduard Shalsi – ryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Shqyrtimi në cilësinë e komisionit përgjegjës i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për zbatimin e lehtësirave të ndërsjella në procedurat doganore dhe/ose të kontrollit të hyrje-daljes së mallrave"

#### **Marrin pjesë:**

Eduard Shalsi, Sorina Koti, Enslemvera Zake, Arbi Agalliu, Emilja Koliqi, Edmond Spaho, Benet Beci, Erion Braçe, Anila Denaj, Bujar Leskaj, Alban Xhelili, Vullnet Sinaj, Pranvera Resulaj, Antoneta Dhima, Shpresa Marnoj.

#### **Mungojnë:**

Blerina Gjylameti, Alfred Rushaj, Jorida Tabaku, Dashamir Shehi, Agron Shehaj,

#### **Të ftuar:**

Besart Kadia - Zëvendësministër i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Arjana Dyrmishi - Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit Ekonomik

Naum Dushku - Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Procedurave Doganore (DPD)

## HAPET MBLEDHJA

**Eduard Shalsi** – Të nderuar kolegë deputetë, përpara se të fillojmë mbledhjen verifikojmë kuorumin. Kuorumi është. Mbledhjen e deklaroj të hapur dhe mediat mund të hyjnë.

Sot kemi për shqyrtim projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për zbatimin e lehtësirave të ndërsjella në procedurat doganore dhe/ose të kontrollit të hyrje-daljes së mallrave". Kemi të pranishëm përfaqësuesit e ministrisë, ndërkohë që relatore është zonja Antoneta Dhima.

Atëherë i jap fjalën relatores të na bëjë një shpjegim të projektligjit.

**Antoneta Dhima** – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, ky projektligj është diskutuar në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi nga Komisioni i Politikës së Jashtme dhe është miratuar me vota unanime. Ne si Komision i Ekonomisë dhe Financave e shqyrtojmë këtë projektligj në cilësinë e komisionit përgjegjës, bazuar në Rregulloren e Kuvendit, gjithashtu edhe në Kushtetutë, edhe në ligjin nr.44/2016 "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë".

Qëllimi i marrëveshjes është intensifikimi dhe përpjekjet e Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për zbatimin e lehtësirave në procedurat doganore dhe/ose të kontrollit të hyrje-daljes së mallrave, si konfirmim i marrëveshjes kuadër, e cila është firmosur në datën 11 janar 2014 midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës. Kjo marrëveshje ndër shtyllat kryesore të saj, ka harmonizimin gradual të legjislacionit dhe të standardeve në fushën e sigurisë së produkteve ushqimore dhe joushqimore, shëndetit të bimëve dhe të kafshëve me interes të ndërsjellë, shkëmbimin e informacionit, të dokumentacionit dhe ndërveprimin e sistemeve elektronike të doganave, harmonizimin dhe thjeshtëzimin e procedurave të transitit, zhvillimin/përmirësimin e sistemit të deklarimit në doganë.

Në kuadër të mbledhjes së përbashkët që është zhvilluar midis qeverisë shqiptare dhe asaj të Kosovës më 26 nëntor 2021 në Elbasan, është nënshkruar marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për zbatimin e lehtësirave të ndërsjella në procedurat doganore dhe/ose të kontrollit të hyrje-daljes së mallrave, sipas tekstit që është pjesë e gjithë dokumentacionit, që anëtarët e këtij komisioni e kanë në dispozicion. Aty përcaktohet qartë qëllimi dhe dispozitat e përgjithshme duke synuar zbatimin e

lehtësirave, thjeshtimin e kryerjes së procedurave doganore, si dhe zvogëlimin e kohës së pritjes në pikat e kalimit kufitar me anë të kryerjes së procedurave doganore dhe/ose kontrolleve të vendit tjetër, për mallrat që kanë destinacion hedhjen në qarkullim të lirë, destinacion final të përdorimit në territorin doganor të këtij vendi, nga personeli doganor i këtij vendi, që do të vendoset pranë zyrave doganore të vendit pritës.

Gjithashtu, bëhet fjalë për kryerjen e procedurave doganore dhe/ose kontrolleve të vendit tjetër, Republikës së Shqipërisë në rastin konkret apo Republikës së Kosovës, ndjekur nga procedura doganore të eksportit të vendit eksportues, për mallrat fruta, perime (zarzavate), të prodhuara në Republikën e Shqipërisë apo në Republikën e Kosovës, për të cilat është bërë njohja e përbashkët e certifikatave fitosanitare, që do të hidhen në qarkullim të lirë me destinacion final të përdorimit në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë apo të Republikës së Kosovës, sipas eksportit direkt nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Kosovës; njohjes reciproke nga palët të licencave të agjencive doganore dhe regjistrimit të tyre pranë autoriteteve kompetente doganore; miratimit të rregullave për vendosjen; kryerjen e procedurave dhe lëvizjen në territorin e palëve të personelit zyrtar të tyre; përcaktimit që në zonën doganore të portit të Durrësit dhe të Porto Romanos të vendoset zyra doganore e Republikës së Kosovës dhe, në vijim, sipas interesit reciprok të palëve, vendosjen e zyrave dhe të agjencive të tjera të palës tjetër, në zonat doganore në territorin doganor të palës vendase; nënshkrimi në emër të palëve të protokolleve të veçanta, palët miratojnë edhe vendosjen e zyrave të tjera dhe/ose zgjerimin e mëtejshëm të lehtësimit e të thjeshtimit të procedurave doganore dhe/të kontrollit të hyrje-daljes së mallrave.

Efektet financiare,

Nëpërmjet këtij projektligji nuk parashikohen efekte financiare në buxhetin e shtetit. Ndërkohë, në marrëveshje nuk janë parashikuar shpenzime konkrete, pasi kjo marrëveshje është në fazën e procedurave dhe është e pamundur të planifikohen efektet financiare të mundshme. Parimisht, pala tjetër, që shkon në territorin e palës vendase, do të ketë detyrimin për shpenzimet lidhur me mjediset e punës, instalimet e nevojshme, si dhe shpenzime të tjera sipas rastit, por shpenzimet konkrete do të parashikohen në protokollet përkatëse.

Cilat janë institucionet që do të jenë pjesë e zbatimit të kësaj marrëveshjeje? Do të jenë Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Ministria e Brendshme, Policia e

Shtetit, Autoriteti Portual, si dhe institucione apo agjenci të tjera të përfshira për zbatimin e kësaj marrëveshjes.

Ftoj të gjithë kolegët deputetë ta miratojmë këtë marrëveshje, pasi është një marrëveshje që ndikon në zhvillimin ekonomik, social dhe njëkohësisht në shkëmbimin e produkteve midisi dy vendeve, Shqipërisë dhe Kosovës.

Meqë e kam fjalën, zoti kryetar të bëj edhe dy pyetje?

**Eduar Shalsi** – Në fillim për pyetje, zoti Agalliu, zonja Koliqi, zonja Dhima mbani shënim.

**Arbi Agalliu** – Kryetar, dua të nge një shqetësim personal. Ne e zhvillojmë këtë mbledhje komisioni sot në një ditë që po ndodhin zhvillime, qoftë në arenën politike, qoftë në jetën sociale, si rezultat i luftës së Rusisë me Ukrainën. Prej ditësh, tashmë, prej një jave, shoqëria civile ka ndërmarrë disa protesta, jemi përballur me një rritje të çmimeve, dikush mendon se është përtej ndikimit që ka ky konflikt ka edhe abuzim nga sektorë të caktuar, kështu që unë e shikoj të udhës që ky komision të thërrasë për të dëgjuar ministren e Financës, ministren e Infrastrukturës dhe Energjisë, ministren e Bujqësisë dhe Autoritetin e Konkurrencës. Të katërt këta përfaqësues, gjykoj që duhet të vijnë këtu të na shpjegojnë paketën e ndihmës që u dëgjua dje nga Kryeministri, ku në dijeninë time një pjesë e mirë e tyre ishin të parashikuara për të hyrë në fuqi, pasi i kemi kaluar në projektbuxhetin në muajin dhjetor. Pra, një pjesë e tyre ishte e parashikuar.

Ne kemi mendime, apo mund të bëjmë diskutime të cilat mund t'i vijnë në ndihmë kësaj qeverie për të marrë masa siç duhen, larg vulgaritetit të Kryeministrit për krahasimin që u bëri atyre njerëzve që protestonin si njerëz të papërgjegjshëm dhe që duhej solidaritet me njerëzit që vriten në Ukrainë, ndërkohë që dy orë më pas Maluma vjen me lekët e taksapaguesve shqiptarë dhe këndon në sheshin “Nënë Tereza”, por kjo është gjë tjetër.

Kështu që, i nderuar kryetar, dua t'i bëj thirrje komisionit, që të gjithë bashkë, që të mos jetë vetëm një kërkesë imja, të thërrasim në seancë dëgjimore përfaqësuesit e këtyre katër institucioneve, për të na shpjeguar se çfarë po ndodh, çfarë masash janë marrë, çfarë masash janë shtesë nga ato që ishin parashikuar në buxhet, që të japim edhe ne mendimin tonë, të bëjmë edhe ne diskutimin tonë, në mënyrë që kjo paketë të jetë reale dhe jo fasadë, jo populiste në këtë situatë. Patjetër, për fat të keq, rritje të çmimeve do të ketë, por ama qeveria amortizimin e

efekteve do të duhet ta bëjë te shtresat në nevojë, te shtresat më vulnerabël apo te biznesi. Kështu që, ky është propozimi im para se të vijojmë me temën e ditës sot.

**Eduard Shalsi** - Zonja Koliqi.

**Emilja Koliqi** - Faleminderit, zoti kryetar!

Në vijim të asaj që tha edhe zoti Agalliu edhe unë jam dakord me propozimin e tij. Në fakt, unë i kam kërkuar që në muajin dhjetor ministres së Financave të na tregonte se çfarë kishin parashikuar si ministri për të përballuar goditjen që do të merrte ekonomia shqiptare, individët, familjarët, por edhe bizneset. Megjithëse unë e kam përsëritur këtë pyetje edhe një muaj më vonë, nuk kam marrë asnjëherë përgjigje. Ndërsa, në seancën e ditës së enjte, ministrja e Financave tha që tani kemi filluar analizën me skenarë tejet pesimistë. Pra, qeveria ende nuk ka bërë një analizë të saktë të gjendjes se ku ndodhen vështirësitë ekonomike. Njëkohësisht, me paketën e rezistencës sociale që është ndërmarrë, sipas analizë së Eurostatit rreth 50% e popullsisë është nën nivelin e varfërisë, mbështetja vetëm për 430 mijë vetë nuk më duket një mbështetje e vërtetë ekonomike, sepse nga këto çmime nuk preken vetëm 430 mijë vetë, por preket e gjithë popullsia dhe për më tepër shtresat e mesme.

Ndërsa në lidhje me marrëveshjen që po shqyrtojmë sot, kjo marrëveshje kuadër është nënshkruar që në vitin 2014 për bashkëpunim, për nxitje dhe lehtësi të tregtisë midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, dua të bëj një pyetje. Sa marrëveshje, sa memorandume ose sa protokolle janë nënshkruar që në vitin 2014 e deri sot? Sa zbatohen ato në praktikë? A janë arritur të gjitha objektivat e vendosura në këto memorandume?

Njëkohësisht, me sa di unë, që vitin 2014 është një pikë doganore e Kosovës në Portin Durrësit. Në vijim të kësaj marrëveshjeje, edhe sa pika doganore të tjera do të hapen? Ku do të jetë vendndodhja e këtyre pikave doganore, që do të shërbejnë për lehtësimin e procedurave doganore ndërmjet dy vendeve?

Shpeshherë kanë pasur ankesa transportuesit e mjeteve të rënda për vonesa shumë të gjata në pikat kufitare dhe megjithëse ka pasur deklarata të vazhdueshme për lehtësimin e procedurave doganore këto nuk janë arritur deri tani. Cilat kanë qenë arsyet e vonesave? Pse ka ndodhur kjo vonesë e madhe për nënshkrimin e marrëveshjeve midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë për lehtësimin e procedurave doganore? Kur mendohet se do të realizohet faktikisht kjo lehtësi, në mënyrë të tillë që të mos kemi më vonesa në pikat doganore, në një kohë që edhe tregtia me Kosovën është gjithnjë në rritje?

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** - Zonja Dhima, mbaji shënim, se po ndërhyjnë kolegët për procedurë.

Po, zoti Spaho.

**Edmond Spaho** – Duke u kthyer te propozimi i zotit Agalliu, grupit të ministrave t'i shtohet edhe zonjusha Bora Muzhaqi, që specifikisht të vijë të na sqarojë se ku thuhet që ministrat janë të detyruar të lëvizin me makinë. Unë kam parë ministra, kryeministra, gjithandej, që lëvizin në këmbë, me makinë, me biçikletë, me tren.

Së dyti, kur të vijë zonja Belinda Ballku të na sjellë sa më shumë informacion sesi populli shqiptar shkon e blen bukën me makinë

**Eduard Shalsi** – Po, zonja Dhima,

**Antoneta Dhima** - Faleminderit, zoti kryetar!

Kam dy pyetje.

E para, si do të implementohet kjo marrëveshje nga ana procedurale dhe kontrollit pas zhdoganimit për mallrat e akcizës, të cilat importohen kryesisht në portet hyrëse ose dhe në pikat doganore?

E dyta, a ka nisma ose marrëveshje të tjera, të cilat janë në procedurë nënshkrimi ose negociimi me vende të tjera të rajonit?

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – A ka kolegë të tjerë që kanë pyetje?

Po, zoti Leskaj.

**Bujar Leskaj** – Megjithëse me vonesë, edhe nga programet e qeverisë suaj, marrëveshja është nënshkruar në vitin 2014, ju e konsideroni tani, kjo është për t'ju përgëzuar. Fakti që hapet një zyrë doganore e Republikës së Kosovës është sukses pavarësisht se me shumë, shumë vonesë. Megjithatë, unë uroj që kjo hapje të mos jetë në kuptimin e ngushtë zyrës, por të jetë vërtetë zyrë, zonë doganore e gjithë në shërbim të biznesit të Kosovës.

Përpara shumë vitesh, rreth viteve 2008, 2009, 2010 dhe në vijim është bërë një kërkesë dhe unë kam qenë njëri nga ata deputetët që e kam ngritur si çështje në Kuvend, që Porti i Shëngjinit të vendoset në funksion të ekonomisë së Kosovës, në funksion të biznesit të Kosovës, në funksion të raporteve ekonomike që ata do të ndërtojnë, në funksion të daljes së ëndërruar në Adriatik të Republikës së Kosovës.

Kjo ka qenë një dëshirë e mirë e shumë faktorëve politikë vendas, por për fat të keq u duk sikur eci pak, pastaj ngeli gjatë rrugës dhe më pas u implementua kjo marrëveshje, e cila është një implementim i pjesshëm i idesë sime. Është ndryshe që një port si ai i Shëngjinit të jetë totalisht në funksion të zhvillimit të ekonomisë së Kosovës dhe ndryshe kjo që kërkoni të bëni ju. Megjithatë, populli ynë ka shprehje të mira dhe të bukura, që të ëmbëlsojnë si: “Kur s’ke pulën do hash sorrën”.

A mund të më jepni një informacion, ka ecur projekti i Portit të Shëngjinit që vendoset në funksion të zhvillimit të ekonomisë dhe të biznesit të Kosovës në këto 8, 9 vjet të qeverisjes suaj?

Marrëveshja e lirë me Kosovën për eliminimin e taksave të dyfishta është nënshkruar, për hir të së vërtetës, që në vitin 2003, e cila eliminonte barrierat e dyfishta, megjithatë burokracia vepron dhe në momente të caktuara ka pasur edhe tendenca për privilegje ose për evazion nga subjekte të caktuara që kanë gëzuar mbështetjen qeveritare. Unë nuk dua ta prish atmosferën e marrëveshjes sot dhe të kaloj në akuza, por jam i interesuar për këtë projekt, për zhvillimet e tij, për tentativat që janë bërë për thellimin, për implementimin dhe për konkretizimin e tij. Kjo, nisur edhe nga fakti që në vitin 2014 u nënshkruan shumë marrëveshje dhe çdo 4 vjet ju nënshkruani marrëveshje, por mua më duket sikur këto janë më shumë marrëveshje në letër.

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Zonja Denaj.

**Anila Denaj** – Faleminderit, kryetar!

Kam disa pyetje për zëvendësministrin, dua të më japë përgjigje, duke shpresuar që të jetë korrekt.

Së pari, në nenin 5 ju thoni që për shkëmbimin e informacionit dhe sistemet informatike ka rregulla të qarta. Dua të di, këto rregulla të qarta si i zgjidhin problemet e mëparshme të adresimit të ankesave që kanë bërë bizneset, për faktin që sistemet nuk janë të interferuara, dhe ka përsëritje dhe kohë për hedhjen një herë te një sistem dhe një herë te sistemi tjetër? Ky ka qenë njëri nga problemet te pika e doganës në Durrës.

Sigurisht, ekzistenca fizike është shumë e rëndësishme, por është e nevojshme që të gjitha procedurat të jenë në harmoni për të kursyer kohë dhe energji, si dhe që sistemet të jenë të inkuorporuara.

Së dyti, në raport me certifikatat fitosanitare që kanë qenë një problem tjetër i bizneseve, pasi duhet të unifikohen, mbase kjo është diçka që shkon përtej kësaj marrëveshjeje, por na duhet një informacion për këtë pjesë.

Një nga ankesat që kanë pasur bizneset ka qenë në lidhje me kontrollet, që përsëri ligji i rregullon, por ankesat kanë qenë në raport me faturat. Kjo është një pjesë operationale, nuk është çështje ligjore, pasi ligji është i rregulluar. Operationalisht, si sigurohet që nëpërmjet kontrolleve, problemet operationale të bizneseve të vijnë në një faturë të plotë dhe jo në disa fatura? Bëhet fjalë për pjesën e skanimimit.

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Faleminderit, zonja Denaj!

A ka njeri tjetër pyetje? Nuk ka.

Përpara se t'u jap fjalën përfaqësuesve të ministrisë, dua të sjell në vëmendje se të ftuar për këtë çështje kemi nga Ministrisë e Financave zotin Besart Kadia, Edlira Demiraj, Arjana Dyrmishi, Naum Dushku dhe Irsiana Neziri.

Ju thashë pak më parë kolegëve, kërkova ndjesë kësaj here, por është hera e fundit që në Komisionin e Ekonomisë dhe të Financave vjen një listë me persona nga të cilët vetëm njëri është në orarin e përcaktuar për fillimin e mbledhjes. Nuk ka asnjë arsye dhe nuk ka asnjë justifikim që të lejojnë të përsëritet një rast i tillë. Kështu që, e diskutova paraprakisht edhe me kolegët deputetë, meqenëse ju, jeni sot këtu, do t'i transmetohet kjo gjë edhe ministres.

Kur vjen një listë me përfaqësues dhe nga lista me 5 përfaqësues në fillim vjen vetëm një dhe pastaj një tjetër në mbledhje, ka diçka që tregon mungesë totale serioziteti.

Pra, nuk do ta lejojmë të përsëritet një rast i tillë dhe nuk do i japim shansin njeriu që të përsërisë një gjë të tillë. E kuptojmë fare mirë, në një moment ose në një tjetër, dikush ka një hall apo mund të ndodhë diçka e papritur, por që nga 5 veta në orën 10:00 të vijë vetëm 1 dhe pjesa tjetër të mos jetë, kjo është e patolerueshme, kjo është mungesë serioziteti dhe nuk do lejohet të ndodhë përsëri.

I jap fjalën për përgjigjet e pyetjeve përfaqësuesve të ministrisë.

E thashë, ndodhi këtë herë, por kjo gjë që nuk do të ndodhë më.

Atëherë, fjala për përfaqësuesit e ministrisë, për t'iu përgjigjur pyetjeve.

Dakord, zonja Dhima, zonja Denaj, zonja Koliqi dhe zoti Leskaj kanë bërë pyetje.

**Besart Kadia** – Faleminderit kryetar!



Në emër edhe të përfaqësuesit ligjor, ka pasur një keqkuptim me orarin, nga ora 11:00...

**Eduard Shalsi** - Zoti Kadia, ju lutem, nuk është nevoja të jepni asnjë shpjegim.

**Besart Kadia** – Pse jo? Meqenëse e thatë, po mundohem të shpjegoj.

**Eduard Shalsi** - Sepse çdolloj justifikimi është i papranueshëm në këtë moment.

**Besart Kadia** – Dakord!

Shkëlqyeshëm!

Faleminderit dhe kërktoj ndjesë për vonesën edhe në emër të përfaqësuesve të tjerë!

Për sa i përket nenit 5, zonja Denaj, nuk e di çfarë ishte pyetje konkrete në këndvështrimin tuaj. Pra, është çështje teknike, ndoshta do të donit të dinit se si funksionon sistemi?

Nëse keni diçka për të shtuar ose për të ndryshuar, jemi gati.

*(Deputetja Denaj flet pa mikrofon.)*

**Anila Denaj** – Së pari, zoti Kadia, na kurseni arrogancën.

Në këtë komision ka deputetë të parlamentit dhe ju vini si përfaqësues i ministrisë, jo si individ. Ndaj, si individ, arrogancën, shpreheni aty ku duhet!

Unë ngrita disa pyetje. Në qoftë se ju nuk dini përgjigjet, as edhe ankesat që kanë pasur bizneset, mund të thuhet shumë kollaj: “Nuk e di”, sepse mundet që një zëvendësministër të mos e dijë, sidomos ju. Të sillni këtu arrogancë dhe të më thoni mua: “Ta sjell me shkrim”, unë e di përgjigjen. Ama arrogancën, këtu në këtë komision, si deputetë këtu nuk ta pranoj! Në rregull?

Madje, këtu, kryetar, unë kërktoj të merret masë. Ajo përgjigje është fyese dhe është e tillë sepse një person që vjen i papërgatitur, përveçse vjen 45 minuta me vonesë, dhe kërkon të justifikohet, është turp!

Shumë faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Viojmë me përgjigjet e pyetjeve të tjera.

*(Diskutime në sallë)*

**Arjana Dyrmishi** – Meqenëse pyetjet janë të ndërlidhura, do të mundohem të bëj edhe një parashtrim timin në ndërlidhje të pyetjeve.

Aktualisht, nga viti 2014 deri tani, me Republikën e Kosovës ne kemi lidhur shumë marrëveshje, pra Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, në fusha të ndryshme, ku një pjesë e konsiderueshme, nëse mund të them janë diku në 5 deri 7 kanë të bëjnë vetëm me thellimin e lehtësimit të procedurave doganore.

Marrëveshja e vitit 2014 është një marrëveshje kuadër, e cila përfshin disa elemente, ku angazhohen të dyja palët, në mënyrë që të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për lehtësimin e procedurave doganore, lehtësimin dhe thellimin e bashkëpunimit në fusha të ndryshme.

Në vitin 2018 është lidhur një marrëveshje mes Këshillit të Ministrave, lidhur me funksionimin e procedurave të transitit në Porto Romano, me Republikën e Kosovës.

Gjithashtu, më lejoni të theksoj që ndër marrëveshjet e rëndësishme po të vitit 2018 është edhe njohja reciproke e rreth 42 certifikatave sanitare dhe fitosanitare me Republikën e Kosovës.

Marrëveshja që ne kemi paraqitur sot në formën e ligjit për miratim është një marrëveshje e cila është negociuar në një periudhë 2-vjeçare mes palëve, është nënshkruar vitin e kaluar në dhjetor në mbledhjen mes dy qeverive dhe ju propozohet për miratim sot. Kjo është një marrëveshje e cila ka të bëjë, në krahasim me marrëveshjet e tjera, me një fazë tjetër dhe më të thelluar të procedurës doganore. Nuk mund të flas për një procedurë unike, por në thellim të procedurës doganore për dy arsye.

Së pari, sepse kjo marrëveshje u jep mundësinë të dyja palëve të vendosin zonat doganore, ku do të kryhen procedurat e zhdoganimit për produkte të ndryshme nga të dyja palët.

Kjo marrëveshje saktëson krijimin e zyrës doganore në portin e Durrësit dhe në Porto Romano për Republikën e Kosovës.

Për zonat e tjera doganore, në të cilat do të kryhet procedura për produktet e zarzavateve, për të cilat në vitin 2018 ne i kemi të njohura certifikatat, palët, përmes protokolleve të veçanta, do të përcaktojnë vendin, interesin dhe do të jetë kjo marrëveshje, e cila do t'u japë palëve nënshkrimin e këtij protokolli.

Për sa i përket saktësimit të funksionimit të procedurave të transitit, nga viti 2018, kur është lidhur VKM-ja, ka pasur disa problematika në operim ndërmjet të dyja palëve, të cilat kanë qenë kryesisht të infrastrukturës.

Vitin e kaluar, në mënyrë të suksesshme, mund të themi që u konkludua dhe u dakordësua mes dy administratave doganore “Standardet e përbashkët të operimit”, i cili është një dokument bazë që përcakton nga A-ja te Zh-ja të gjitha procedurat e transitimit të produkteve nga Porto Romano në Republikën e Kosovës.

Nëse ju duhen më tepër detaje, eksperti i Doganës mund të ndalet në procedurat e ASYCUDA-s.

Për sa i përket pjesës së kontrollit të zhdoganimit, kjo marrëveshje, përpos vendosjes së zyrës doganore dhe njohjes së përbashkët të licencave mes të dyja palëve, përcakton që prevalojnë procedurat dhe legjislacioni i secilës palë. Pra, në momentin kur do të bëhet një procedurë zhdoganimi në portin e Durrësit ose në Porto Romano, procedura e zhdoganimit do të kryhet në Kosovë. Pala kosovare ka zyrën e saj fizike, ka doganierët e saj në Porto Romano dhe aty deklarata bëhet nëpërmjet sistemit nga administrata doganore.

Në rast se do të kemi kontrolle fizike, ato janë kontrolle për rastet kur bie “me kanal të kuq”, siç themi, që përdoren analizat e riskut, të cilat i përdor po vetë... Është sistemi i analizës së riskut që operon vetë pala doganore, i bën vetë kontrollet fizike, dhe bëhet procedura nga Porto Romano në Morinë me procedurë transiti. Pra, bëhet riekспорт dhe më pas transit. Aktualisht, procedura e zhdoganimit bëhet në terminalin doganor të palës kosovare.

Për sa u përket marrëveshjeve të tjera, kjo është një marrëveshje të cilën ne e kemi për hapjen e zyrave doganore të palës kosovare në Shqipëri. Pastaj, dhënia e mundësisë të dyja palëve për të hapur zyra të tjera me protokolle të veçanta është vetëm me palën kosovare.

Për sa i përket njohjes reciproke të produkteve të fruta-perimeve, të certifikatave të origjinës, po, kjo është një problematikë, e cila na është prezantuar në tavolinë nga bizneset e të dyja palëve lidhur me funksionimin ose jo të marrëveshjes së vitit 2018. Vitin e kaluar, në mos gaboj, në tetor, ne i kërkuam Agjencisë Kombëtare të Ushqimit të bënte një verifikim dhe një kontroll në terren se sa pala shqiptare i njihte certifikatat, pra se sa e zbatonte këtë marrëveshje. Nga verifikimi në terren na rezultoi që ne kishim një njohje të plotë dhe zbatimin e marrëveshjes së vitit 2018 për sa i përket AKU-së sonë, por i kemi kërkuar zyrtarisht një verifikim në terren dhe një *feedback* edhe AKU-së kosovare.

Janë problematika të cilat ngrihen herë pas here. Ju e dini që ne bëjmë çdo vit mbledhje të qeverive, ku bizneset parashtrojnë problematika, të cilat ndonjëherë janë specifikisht të lidhura me produkte specifike, ndonjëherë janë problematika të cilat i kanë të gjitha bizneset. Për rastin konkret, në shumicën e rasteve na ka rezultuar që nga pala jonë certifikatat sanitare dhe fitosanitare njihen për ato produkte të cilat i përkasin marrëveshjes së vitit 2018.

Lidhur me pro-portin e Shëngjinit, nuk e di nëse përfaqësuesi i doganës mund të përgjigjet, sepse unë nuk e kam këtë informacion...

**Naum Dushku** – Mund të theksoj edhe për Kosovën se çfarë ka bërë administrata?

*(Zonja Dyrmishi ndërhyr pa mikrofon.)*

Për këtë marrëveshje ne kemi parë dy zhvillime, sistemin ASYCUDA, që pas shkurtit i kemi bërë *upgrade*-in dhe e kemi të njëjlojtë me palën kosovare. Dy sistemet janë të unifikuara tashmë. Kjo do të na krijojë mundësinë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kemi paraprirë dy procedura të standardeve. Kemi bërë një manual të përbashkët për procedurat standarde të zhdoganimit në portin e Durrës, si dhe një manual për profilet e riskut.

Koncepti ynë është që, nëpërmjet shkëmbimit të profileve të riskut si për transitin në palën shqiptare, ashtu edhe për importet dhe eksportet në palën kosovare, të kemi shkëmbim nëpërmjet sistemeve, në mënyrë që të kemi një ndalesë ose *one-stop shop*, në mënyrë që kontrolli i palës kosovare të bëhet bashkë me atë shqiptare kur ata mendojnë se do të çlirojnë mallrat, se edhe mund të transitojnë. Janë dy format që mund t'i zgjedhë vetë deklaruesi ose administrata kosovare.

Ne deri dje nuk e kemi pasur zhdoganimin e mallrave në portin e Durrësit dhe në Porto Romano, por kjo marrëveshje do të na e krijojë mundësinë.

Tri shoh si shtylla që na i krijon kjo marrëveshje nga ana teknike.

E para, na lejon çlirimin e mallrave kosovare në territorin shqiptar. Ato do të çlirojnë mallrat dhe pas kësaj në mënyrë automatike sistemi i tyre i ASYCUDA-s, që është import, do ta transferojë te ne. Meqenëse mallrat nuk kanë status shqiptar, do të kalojnë te moduli ynë i transitit dhe do të bëhet transit deri në Vërmicë. Në Vërmicë automatikisht mallrat janë çliruar dhe shkojnë direkt, sepse import 4-a, hedhja në qarkullim të lirë është bërë në Durrës.

Risia tjetër është që kemi lehtësi edhe për mallrat e kapitujve 7-8, ku kemi frutat dhe perimet, sepse mallrat që janë për eksport në Kosovë mund të çlirohen edhe në qarkullim të lirë direkt në doganat ku do të operojnë procedurat e eksportit nga territori shqiptar.

E treta, është njohja e licencave të agjencive doganore, që na i krijon kjo marrëveshje. Presupozojmë që agjentët tanë doganorë shqiptarë dhe ata doganorë kosovarë mund të bëjnë deklarime në sistemet respektive. Domethënë, agjentët shqiptarë deklarojnë te sistemi i ASYCUDA-s së Kosovës, ndërsa atyre të Kosovës u krijohet mundësia për deklarim në sistemin tonë.

Për sa i përket portit të Shëngjinit, ne kemi pasur dy kërkesa nga dy operatorë për të zhvilluar zonë të lirë, për të cilat nuk janë plotësuar ende kushtet edhe nga ana dokumentare që përcakton VKM-ja nr. 626 për zonat e lira.

Deri tani janë të pezulluara deri në plotësimin e dokumenteve.

*(Kryetari i komisionit ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po, kanë kohë.

Madje, njëri subjekt, mund të përmend edhe emra, ka pasur probleme me qiradhënësin përmes Bankës Kombëtare Tregtare.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Eduard Shalsi** – ...në territor shtetëror apo privat?

**Naum Dushku** – Privat. Të dyja janë tek territori privat.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Eduard Shalsi** – Të dyja kërkesat janë për territor privat?

**Naum Dushku** – Po, janë operatorë privatë.

**Eduard Shalsi** – E qartë.

Po, zoti Leskaj.

**Bujar Leskaj** – Duke e falënderuar ekspertin për përgjigjet që dha, desha të them se dukej profesionalizmi të shumica e pyetjeve, por, për fat të keq, te pyetja ime nuk ishte fare në temë. Ajo ishte: a është zhvilluar, a është debatuar, a është analizuar projekti për dhënien në dispozicion të portit të Shëngjinit ekonomisë së Kosovës, biznesit të Kosovës, qeverisë së Kosovës?

Dhe, pavarësisht respektit që kam për ty, respektin personal edhe për zonjën, edhe për zëvendësministrin... Nuk është...?

Kjo mund të quhet pyetje me karakter politik, zoti kryetar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në rregull. Do të kemi rast ta debatojmë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Eduard Shalsi** – Kam edhe një kërkesë. Të ndajmë pjesën e kërkesave që kanë lidhje me projektligjin konkret dhe...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Eduard Shalsi** – Madje, zoti Leskaj, e mbaj mend fjalimin tuaj të fundit në parlament, por do të duhet të insistosh dhe të insistojmë që, sa herë ka seancë parlamentare, deputetët të flasin për projektligjin, sepse është bërë, me thënë të drejtën, një bezdi e jashtëzakonshme fakti

që dalin jashtë temave për të cilat është diskutimi i ligjit, si dhe të inkurajojmë rritjen e debatit të lirë, ku gjithsecili ka mundësi të flasë për temat që do të donte të diskutonte.

Atëherë, e mbyllim...

*(Deputeti Leskaj kërkon fjalën, pa mikrofon.)*

Patjetër, mund ta bëni.

**Bujar Leskaj** – Nisur nga tërheqja e vëmendjes, që bëri ish-ministrja për pyetjen, më bën përshtypje kjo gjë. Neni 5, pika 1...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, te marrëveshja, te marrëveshja!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për përmirësim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ah, ndjesë!

Nuk e...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Braçe, se nuk e kuptoj këtë gjë: pse duhet të vendoset në mënyrë taksative që mund të shkëmbejnë vetëm informacion të paklasifikuar si sekret, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi? Kjo nuk duhet të jetë në mënyrë kufizuese, në mënyrë ndaluese. Kjo duhet të formulohet ndryshe, që edhe informacioni tjetër shkëmbehet.

Megjithatë, ndoshta kur ta marrim ne qeverinë, do ta...

*(Diskutime në sallë)*

**Eduard Shalsi** – Dakord.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kalojmë te miratimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për zbatimin e lehtësirave të ndërsjella në procedurat doganore dhe/ose të kontrollit të hyrje-daljes së mallrave”.

Para se ta miratojmë, kam një kërkesë, në fakt, për Shërbimet e Kuvendit, që të na përgatisin një raport të të gjitha marrëveshjeve që janë lidhur ndërmjet të dyja qeverive dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, por tashmë kemi edhe një zyrë të përbashkët midis të dyja qeverive, që e ka sintetizuar dhe organizuar edhe informacionin më mirë, mund t’ua

vendosni në dispozicion anëtarëve të nderuar të parlamentit në lidhje me statusin e marrëveshjeve të nënshkruara midis qeverive.

Ato që ratifikojmë, i kemi, ndërsa ato të tjerat që nuk i kemi, kur do t'i kemi?

Kishit diçka për të shtuar, zonja Dyrmishi?

**Arjana Dyrmishi** – Vetëm një saktësim të kërkesës: doni marrëveshjet që i kemi në procedura doganore apo tërësinë e marrëveshjeve në fushën sociale, shëndetësore...?

**Eduard Shalsi** – Në fakt, kërkesa ka qenë qëkur e kemi mbledhur këtë komision për këtë legjislaturë për herë të parë, që të kishim të gjithë setin e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet dy qeverive në kohë. Gjithsesi, ju do të bëni pjesën që ju takon juve, ndërsa pjesën tjetër do ta aranzhojmë me zyrën e përbashkët midis dy qeverive, që kanë edhe një titullar që po menaxhon të gjithë këtë proces të rëndësishëm.

Thjesht desha ta sjell në vëmendjen e Shërbimeve të Kuvendit që të organizojnë informacionin, qoftë për të na bërë edhe një *briefing*.

Atëherë, e hedhim në votim në parim projektligjin.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi projektligjin. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe në tërësi projektligji.

Atëherë, para se ta mbyll mbledhjen, ditën e nesërme në orën 10:00 kemi shqyrtimin në cilësinë e komisionit përgjegjës të projektligjit “Për miratimin e programit të statistikave zyrtare”, si pikë të parë dhe, si pikë të dytë, do të kemi shqyrtimin në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi të projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e pjeshme, të zgjeruar për rrugët kulturore, miratuar me rezolutën CM/RES 2013 (66)”.

Në rregull?

Në mos gaboj, dikush kishte diçka për të më thënë në lidhje me miratimin e programit të statistikave zyrtare apo jo? Nuk kishte.

Në rregull.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, zoti Agalliu, përpara se ta mbyllim.

**Arbi Agalliu** – Zoti Shalsi, jashtë kësaj, e konsiderojmë të mbyllur këtë, po i rikthehem edhe një herë asaj që të gjithë bashkë si komision të biem dakord për të thirrur përfaqësuesit e katër institucioneve që përmenda: ministren e Financave, ministren e Infrastrukturës dhe Energjisë, ministren e Bujqësisë dhe përfaqësuesit e Autoritetit të Konkurrencës.

Unë besoj që do të jetë dhe është në të mirën tonë, për të treguar edhe seriozitetin e këtij komisioni, që të jemi në unison me një kërkesë të vetme drejtuar këtyre përfaqësuesve.

**Eduard Shalsi** – Po, tema...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

I nderuar zoti Agalliu, sigurisht që dëgjesat janë një nga instrumentet, por sa më...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Një sekondë, të lutem!

Sa më e strukturuar të jetë kërkesa, aq më larg politizimit është.

Po jetojmë në kohë kur po politizohen çështjet që nuk duhen politizuar, aq më tepër në momente krejtësisht të papërshtatshme.

Ne patëm një rast të parë të dëgjesës së Autoritetit të Konkurrencës, ku na u desh të saktësonim disa pika paraprakisht.

**Arbi Agalliu** – Atëherë, nëse më lejoni...

**Eduard Shalsi** – Nëse do të vijë ministrja e Infrastrukturës, nëse kërkoni ministren, duhet të jeni... Dhe e thashë, dëgjesa është njëri instrument, ndërkohë që keni instrumentin e seancës plenare, keni instrumentin e interpelancës, keni instrumentin...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Arbi Agalliu** – Unë besoj që...

**Eduard Shalsi** – Pra, ka shumë lloje instrumentesh.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nëse nuk do të konkretizoni çështjen për të cilën do të duhet të diskutohet dhe do të duhet të thirret ministrja, atëherë...



**Arbi Agalliu** – Atëherë, po i jap përgjigje.

Unë besoj që diskutimi në Komisionin për Ekonominë dhe Financave është shumë më shumë larg politikës sesa një interpelancë në seancë plenare.

Arsyeja dhe tema është rritja e çmimeve, që po ndodh si pasojë e konfliktit Rusi-Ukrainë dhe jemi të vetëdijshëm për këtë. Çfarë masash po merren nga ministrat përkatës, sepse janë ministrat që përfaqësojnë sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare: energjia, bujqësia, dhe financat?

Po kështu, edhe Autoriteti i Konkurrencës, për të parë nëse kemi abuzime të tregjeve të caktuara, sikurse unë kam bindjen që ka, pra kjo në optikën time, në gjykimin tim.

Pyetja është shumë e thjeshtë: cilat janë masat që këta përfaqësues po marrin në këtë situatë për të amortizuar efektet negative të familjet shqiptare, të biznesi? Sepse një pjesë e mirë e paketës së ndihmës, që Kryeministri parashtrroi dje, është votuar në dhjetor të buxheti i këtij viti.

Kështu që më saktë sesa kjo temë, unë nuk e di, hajdeni ta formulojmë të gjithë bashkë. Prandaj them që është në të mirën e këtij komisioni që ta ngremë si kërkesë.

**Eduard Shalsi** – Në rregull.

Po, zoti Braçe.

**Erion Braçe** – Faleminderit!

Shiko, Arbi, me thënë të drejtën, ashtu është, siç thoni ju, që ky komision duhet të jetë shumë më tepër teknik sesa politik, por edhe politikë do të bëjmë në fund fare, sepse jeni njerëz politikë dhe jemi.

Ajo që mua më shkon për shtat lidhur edhe me të qenit profesionist edhe në këtë komision, edhe teknik, ka të bëjë me aktin.

Qeveria, të gjitha masat që ka afishuar, jo dje, as pardje, por para katër ditësh, i ka produkt të një pune të një komiteti, që është ngritur këtu e dy javë më parë, ndërministror, dhe që ka analizuar situatën, ka bërë ata skenarë për të cilët ju flisni dhe, natyrisht, ka arritur në disa konkluzione shumë të qarta, të cilat do të vijnë në parlament me akt.

Ulja e taksave, vjen në parlament me akt. Pra, e vendos parlamenti uljen e taksave.

Rritja e pagës minimale, natyrisht bëhet me vendim qeverie, por duhet të reflektohet në buxhet këtu.

Ndryshimet buxhetore, që nuk janë pak dhe që shkojnë gati apo prekin diku te gati 430 milionë dollarë, qoftë në të ardhura, qoftë edhe në shpenzime, në rialokime të tyre, do të vijnë në parlament me akt.

Pa diskutim që të gjithë ministrat duhet të jenë këtu, pra jo vetëm ata që ju kërkoni, por edhe të tjerë që impaktohen drejtpërdrejt nga kriza. Ama, t'i referohemi një akti. Domethënë, të mos bëjmë një seancë dëgjimore pa e pasur aktin përpara.

Në momentin kur qeveria i sjell aktet në parlament për të ndryshuar ligjet fiskale apo për të ndryshuar buxhetin e shtetit, pa diskutim që seanca nuk mund të jetë një ditë, mund të jetë dy, mund të jetë tre. Secili prej tyre mund të marrë një ditë të plotë këtu në komisionin parlamentar për të diskutuar lidhur me çështjet.

Por që të mos e kthejmë në politikë, sepse unë vazhdoj të jem kundër që taksat të vendosen aty te sheshi, që çmimet të vendosen aty te sheshi. Nuk mund t'i vendosim...

Cilitdo që del atje e ka një ide të vetën që ule këtë, kap atë, bëj këtë, shto atë, hiqe këtë e të tjera me radhë, por nuk bëhet kështu politika fiskale, as politika buxhetore. As ju nuk e bëni dot, kur të vini në pushte, por as ne nuk e kemi bërë dot gjatë këtyre 9 vjetëve në këtë mënyrë. Nuk bëhet.

Kështu që është shumë e rëndësishme që, në momentin kur të vijnë aktet në parlament, po, të bëhet një program i plotë që gjithsecili të vijë këtu dhe të japë shpjegime deri më një për aktet dhe për të gjitha të tjerat me radhë.

Tani, u përsërit disa herë që një pjesë e tyre janë vendime të marra që në muajin nëntor, me buxhetin e shtetit. Paskan qenë vizionarë që paskan planifikuar që disa masa duhet në merren në mes të këtij viti. Natyrisht, lufta dhe situata në tregjet ndërkombëtare e bëjnë të mundur të bëhen tani. E para.

E dyta, që është po kaq e rëndësishme, njëra prej masave, që lidhet drejtpërdrejt me energjinë elektrike, nuk ishte planifikuar në nëntor. Pa diskutim, ne paralajmëruam se mund të jemi në mes të krizës, por ama të paguash 200 milionë dollarë nga buxheti i shtetit për të mbuluar 80% të faturës së familjarëve në Shqipëri nuk është një masë kaq e thjeshtë. A duhet sqaruar? Po, duhet sqaruar. A mundemi ne të bëjmë një analizë akoma edhe më të thellë për çfarë na pret me krizën energjetike? Pa diskutim që mund ta bëjmë edhe këtu, por ama të kemi një akt përpara, jo thjesht mendimet tuaja, mendimet tona dhe presionin e atyre që rrinë atje, të

cilët thonë se tregu ka monopol, sepse te Ministria e Brendshme është vendosur një kontratë prokurimi trevjeçare për naftën apo të tjera budallallëqe si këto, që thuhet me okë.

Mua më vjen keq, se kemi edhe përgjegjësi të thëmi të drejtën dhe se duhet të marrim vendime. E thashë, një pjesë e gjërave janë vendime që duhet t'i marrë parlamenti i Shqipërisë. Qeveria ia propozon parlamentit, por në fund fare vendos parlamenti dhe përgjegjësia është jona. Përgjegjësia nuk është thjesht ndaj atyre njerëzve që janë aty, por përgjegjësia do të jetë përkundrejt çdo qytetari, edhe atij që del, edhe atij që hesht, edhe atij që rri në shtëpi dhe është i kënaqur.

Propozimi im është të vijmë aktet dhe të bëjmë seancën.

**Eduard Shalsi** – Po, zoti Leskaj.

Përfaqësuesit e ministrisë mund të largohen, sepse kemi mbaruar punë me marrëveshjen.

**Bujar Leskaj** - Vetëm për vendime vizionare të kësaj qeverie nuk mund të flasim. Pavarësisht respektit që unë kam për deputetin parafolës, ne jemi në të drejtën tonë si opozitë, dhe, qoftë kërkesa që u përçoll përmes zotit Agalliu, qoftë përmes zotit Spaho, të gjithë ne jemi në unison për sa i përket kësaj. Nuk ka asgjë të keqe që edhe ne këtu në komision të organizojmë dëgjesa. Çfarë dokumentesh do të presim ne? Çfarë marrëveshjesh do të presim? Ajo është e drejta jonë. Ne si opozitë po kërkojmë të bashkoheni edhe ju në këto dëgjesa në mënyrë që t'i bëjmë sa më profesionale, por nuk kemi pse t'i anatemojmë ata që protestojnë, sidomos këtu në Komisionin e Ekonomisë, sepse ata janë në të drejtën e tyre të kenë mendimet e tyre.

Dje unë dëgjova për herë të parë çfarë thoshin dhe aty doli edhe një vajzë që fliste për sukseset e Kryeministrit, për pikturën, për artin. Ne duhet të kryejmë detyrën tonë.

Unë po ju vë në dijeni që ne, një grup deputetësh, i përbërë nga Sorina Koti, Albana Vokshi, Edmond Spaho, Belind Këlliçi, Edi Paloka, Flamur Noka, Isuf Çelaj dhe Bujar Leskaj, bazuar në nenin 80, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në mbështetje të nenit 97 të Rregullores së Kuvendit, kemi kërkuar interpelancë urgjente me Kryeministrin Rama për deklaratat e tij.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po ju vë në dijeni si Komisioni i Ekonomisë, për respektin që kam për ju, meqenëse e diskutuam këtë, se kryetari nuk e mbylli.

Më specifikisht, ne e kemi kërkuar interpelancën për çështjet, si vijon:

Për paketën e masave për përballimin e krizës, gjendjen e rezervave materiale të shtetit, gjendjen e rezervave të sigurisë së naftës. Gjithashtu, kërkojmë përfshirjen e kësaj interpelance pikë të parë të rendit të ditës së seancës plenare të kësaj jave, sipas nenit 97, pika 2, kjo edhe për shkak të rëndësisë së çështjeve që po trajtojmë dhe që prek çdo qytetar shqiptar.

Në rastin konkret të protestave, për raportin që ne si komision duhet të kemi me protestat, me qeverinë, me partitë politike, unë mendoj që ne duhet të vazhdojmë me këtë filozofi të punës së komisionit. Është shumë mirë t'i vazhdojmë edhe dëgjesat paralelisht, sepse veprimet paralelisht do të kryhen, nuk është se ne duhet të presim të vijë një dokument nga qeveria dhe pastaj të ...

**Eduard Shalsi** – E qartë kërkesa.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, do jua jap fjalën.

Zoti Leskaj, faleminderit që na vure në dijeni për pjesën e interpelancës, sepse praktikisht po kërkonin në interpelancë ato gjëra që po ua kërkojmë 1, 2 apo 3 ministrave në dëgjesë! Pra, do të dëgjojmë përgjigjen e Kryeministrit, që, për hir të së vërtetës, ka prezantuar vazhdimisht në publik shqetësimet dhe masat, dhe pastaj e shikojmë.

Çështja që unë kam është që, kur të thërrasim një ministër, duhet ta strukturojmë sa më mirë dëgjesën. Për shembull, që para 2 vjetësh, 3 vjetësh, 1 viti apo edhe 2 muajsh, unë vetë kam insistuar për zbatimin e një VKM-je për hidrokarburet. E kam përsëritur dhe stërpërsëritur impaktin e gjurmueshmërisë apo të sistemit “*track and trace*” dhe çfarë sjell për formalizimin, për ekonominë dhe për disiplinimin e trajtimit të hidrokarbureve.

Po, e kemi lënë. Pse nuk është zbatuar kjo? Unë besoj se është një element crucial, shumë themelor, për të parë se çfarë impakti ka. Çdolloj deklaratë në protestë, jo në protestë apo dëshirë për të sistemuar apo për vendosur rregull në një treg ku mungon një instrument i tillë, është dëshirë, ndërkohë që instrumentet për ta bërë një gjë të tillë ...

E njëjta gjë vlen edhe për inputet bujqësore. Është tmerr të marrësh një informacion për të kuptuar realisht marzhet, për të kuptuar realisht cilën pjesë të bilancit zënë produkte të caktuara, si mund të monitorohen dhe se si mund të kontrollohen. Ndërkohë, më rastisi të shikoja dy sisteme jashtë, ku proceset ishin të digjitalizuara në një mënyrë të tillë që nuk linin as

hamendësime protestuesish, as hamendësime deputetësh, as hamendësime shkencëtarësh, sepse të dhënat atje ishin aq të sakta sa që kuptohej çfarë kishin bërë dhe çfarë donin të bënin.

Ndaj, e kam merak pjesën e strukturimit të debatit dhe të gjërave që kërkojmë. Absolutisht, nuk kemi qenë kundër asnjëherë, madje ne e kemi incentivuar pjesën thirrjes në dëgjese, por në rastin konkret ju paskeni thirrur në interpelancë Kryeministrin pikërisht për këto çështje. Ndaj, të dëgjojmë Kryeministrin dhe pastaj të vijojmë paralelisht.

Fjalën e ka zoti Braçe dhe pastaj zoti Spaho.

**Erion Braçe** - Zoti Leskaj, unë nuk thashë në asnjë sekondë të fjalës sime që këtu nuk duhet të vij në ministra, përkundrazi, unë thashë të vij në ministra dhe të rrinë edhe gjithë ditën, për t'iu përgjigjur çdo shqetësimi që ka secili nga kolegët, por që ka edhe populli, po të doni, që lidhet drejtpërdrejtë me efektet e çmimeve në treg, por, pa më të voglin diskutim, ky komision duhet të ketë vetëm marrëdhënie institucionale me ata që mblidhen atje.

Tregjet kanë nevojë për qetësi, nuk kanë nevojë për budallallëqe. Pa diskutim, budallallëqet është i lirë t'i thotë nga mëngjesi deri në darkë kush të dojë, si të dojë, t'i përdorë, t'i sjellë si element manipulimi e të tjera me radhë, por tregjet, edhe këtu në Shqipëri, kanë nevojë për qetësi, për transparencë, por edhe për kontroll, sepse ky i fundit mungon nga të gjitha agjencitë, qoftë ato fiskale, qoftë edhe ato që janë inspektorate dhe që duhet të bëjnë detyrën e tyre në këtë mes.

Ajo që ju sugjerova është thjesht dhe vetëm një gjë, një akt. Për sa kohë që qeveria do të sjellë javën tjetër në parlament të gjithë vendimmarrjen e saj lidhur me këtë paketë dhe me shqetësimet që ju ngrini, nuk kemi pse bëjmë dy seanca, por bëjmë një seancë për çdo çështje referuar aktit që vjen këtu. Kaq.

Çfarë ka? Nëse keni propozime, patjetër që do të reflektohen aty. Nëse keni shqetësime, t'i dëgjojmë dhe gjithsecili të marrë përgjigje. Ne kemi shqetësime akoma edhe më të mëdha, sepse, për të thënë të drejtën, ata që heshtin janë një pjesë shumë e madhe jona, dhe natyrisht që duan përgjigje. Patjetër, do të ngremë edhe ne shqetësimet tona dhe gjëja të shkojë deri në fund. Çfarë shqetësimi ka këtu? Unë nuk thashë që të mos bëhet seanca me ju. Patjetër, seanca të bëhet me secilin prej ministrave, por ama të jemi pjesë të dyja palët. Nuk mund të diskutojmë për hamendësime, por të diskutojmë për dokumente të shkruara që vijnë këtu dhe t'i shtyjme përpara, siç e ka procedura e parlamentit. Shumë e thjeshtë.

E gjithë situata ka nevojë për qetësi. Është shumë e rëndësishme që njerëzit të kuptojnë që ka edhe miell, ka edhe vaj, ka edhe oriz, ka edhe sheqer dhe nuk duhet të dynden për të blerë nga 20-30 kilogramë, siç kanë blerë, zoti Leskaj, ashtu siç të gjithë këta që i tregtojnë këto produkte kanë nevojë të kuptojnë që ka kontroll dhe këta nuk mund të ulin ofertën artificialisht, duke tërhequr mallra nga qarkullimi dhe duke i mbajtur nëpër magazina. Këto dy gjëra janë. Prandaj duhet qetësia, prandaj duhet kontrolli dhe prandaj duhet konkurrueshmëria

**Eduard Shalsi** – Po, zoti Spaho.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Bujar Leskaj** - Unë jam dakord me ju që tregjet kanë nevojë për qetësi, por ama që edhe vendi dhe kjo qeveri kanë nevojë për protesta të forta popullore dhe demokratike, nuk e luan as topi. E para.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jam dakord me ju.

Këtë që thatë për kontrollin, dhe bëtë shumë mirë, thuajani edhe qeverisë suaj.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Deri tani qeveria ka deklaruar që nuk mund ndërhyjë në rregullat e ekonomisë së tregut, tregun e lirë dhe institucione të tjera, përfshirë edhe Autoritetin e Konkurrencës, që, me të drejtë, ju keni ngritur shumë probleme. Ndoshta keni qenë i pari dhe i vetmi deputet.

Ne nuk kemi pse të ndërhyjmë te protestat, sepse protestat janë të popullit. Ato janë e drejtë legjitime e tij dhe janë shuplakë edhe për qeverinë, por njëherazi edhe për ne si opozitë. Ne duhet të bëjmë detyrën tonë si ligjvënës dhe si përfaqësues të popullit dhe duhet të kërkojmë atje ku mund të kërkojmë ndaj qeverisë.

**Eduard Shalsi** – Në rregull jemi. Nuk ka debat për këtë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Edmond Spaho** - Në fakt, thirrja e qeveritarëve në Komisionin e Ekonomisë është një mekanizëm për të trajtuar shqetësimet që ka shoqëria dhe është krejt normale t'i thërrasim.

Jo më kot e bëra edhe propozimin. Unë nuk kam ndonjë kuriozitet të dëgjoj përgjigjet për paketën, sepse i kam dëgjuar, ka folur Kryeministri, por unë e quaj skandal filozofinë me të cilën punojnë dhe drejtojnë ministrat dhe qeveria. Kjo është filozofia e patricëve dhe e plebenjve. “Populli shkon blen bukë me makinë”. Po ta kishe thënë me ndonjë vend tjetër të Europës këtë gjë, menjëherë ministrja do të jepte dorëheqje. Në qoftë se nuk do ta jepte ajo, Kryeministri do

ta merrte me shkelma. Po të thuash “unë si ministre e kam për detyrë të udhëtoj me makinë, kurse ju si popull, për të mbrojtur mjedisin, duhet të ecni në këmbë”, bie qeveria. E thua dot këtë gjë në Itali? E thua dot këtë gjë në Gjermani? E thua dot këtë gjë në Angli? Thuaje po deshe dhe do të shikosh ku shkon!

Pra, këtu sundon arroganca dhe kjo është shumë shqetësuese. Shikoni edhe sjelljen e Kryeministrit. Prandaj, ai duhet të vijë të na sqarojë për këto gjëra, si i koncepton dhe pse i drejtohen me këtë ton popullit të vet. Edhe ata njerëz që dalin në rrugë, dalin se nuk po i dëgjon njeri. Kryeministri tha “çmimet i vendos tregu, ato janë rritur dhe do të rriten”, por kur njerëzit dolën në rrugë, u detyrua të tërhiqej dhe të nxirrte paketën. Edhe unë e di që nuk vendosen çmimet në rrugë, por kur qeveria nuk të dëgjon, atëherë populli del në rrugë. Nuk ka pasur nevojë të dalë në rrugë as populli kroat, as populli maqedonas, as shqiptarët e Kosovës, as populli grek. Pse? Sepse vetë qeveritë në ato vende kanë qenë pararendëse dhe kanë marrë masat. Populli grek nuk ka dalë në protestë po them, sepse qeveria ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, e kam fjalën për rastin e çmimeve. Nëse ka dalë, akoma edhe më mirë, por di që qeveria greke tha hapur “për një javë do të publikojmë paketën për të mos lejuar rritjen e çmimeve”. Shqetësimi ynë këtu dhe i atyre që kanë dalë në protestë është që në Shqipëri ka monopole, jo pse po rriten çmimi nga lufta në Ukrainë. Për shembull, në vitin 2010 një fuçi karburant ka kushtuar 150 dollarë dhe çmimi shkoi deri në 1550 lekë për litër. Që nga viti 2010 deri më sot janë rritur taksat me 300 lekë për litër; 270 lekë akciza plus 30 lekë të tjerat, dhe çmimi sot duhet të ishte 1880 – 1900 lekë për litër nëse çmimi do të ishte 150 dollarë për fuçi. Sot çmimi është 105 dollarë për fuçi dhe komisioni i famshëm, që u ngrit për këtë punë, vendos çmimin 2170 lekë për litër. Kjo do të thotë të marrësh në mbrojtje interesat e oligarkëve. Ky është problemi, jo lufta në Ukrainë. Luftën në Ukrainë do ta përballojmë, por që oligarkët, matrapazët, xhambazët të vjedhin dyfishin në kushtet e luftës nuk mund ta përballojnë dhe nuk mund ta lejojnë dot, sepse nuk është sakrificë që na takon neve ta mbajmë.

Shembull tjetër është mielli. Ne këtu bëme një debat me Autoritetin e Konkurrencës, institucionin që e ka ndjekur për 2,5-3 vjet dhe që ka konkluduar që sjellja është monopol, por nuk vë gjoba. Atëherë, çfarë duhet të presim ne? Këto janë problemet që na shqetësojnë dhe që duam t’i sqarojmë me ata që vijnë këtu.

**Eduard Shalsi** – Zoti Spaho, unë e kuptoj se doni që, qoftë edhe Autoriteti i fundit që përmendët, në 3 muaj të rregullojë të gjitha boshllëqet ekonomisë shqiptare.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Një sekondë.

Unë e di edhe qëndrimin tuaj konstant për mënyrën si është menaxhuar pandemia, unë e di shumë mirë edhe qëndrimin tuaj në lidhje ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ta mbaroj, të lutem! Unë ju dëgjova me durim ndonëse nuk bie dakord me ju, ndaj, ju lutem, bëjeni edhe ju një gjë të tillë! Ju kam dëgjuar të flisni edhe për çështjen e tërmetit. Dakord? Ndërkohë, faktet po provojnë se, qoftë për tërmetin, qoftë për pandeminë, qeveria shqiptare ka bërë ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Qartë, pra.

Nuk mund të jesh i saktë nëse nuk zbaton rregullat. Akuzon tjetrin për arrogancë, ndërkohë që dëshmon arrogancë duke më ndërprerë minutë pas minute. Pra, unë po them opinionet e mia.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Fakteve mund t'u referohesh me argumente.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sipas teje. Më lejo ta mbaroj.

Pra, kjo qeveri ka provuar se gjëja e fundit që mund t'i bësh është ta shantazhosh nëpërmjet forcës apo rrugës, përkundrazi, ka reaguar me shpejtësi dhe momentet krize i ka shndërruar në momente mundësie për t'u rritur. Faktet janë kokëforta, dëshmohen nga institucionet shqiptare, dëshmohen edhe nga institucionet e huaja. Sot kemi përballë një krizë botërore. Sot po shikojmë skarcitetin, po shikojmë çmimet e hekurit, të letrës, të drithërave, ndërkohë që po flasim për sisteme të brendshme. Unë jam për sisteme, zoti Spaho, nuk jam i mendimit që të pushkatojmë Autoritetin e Konkurrencës prej vitesh, duke i treguar se si duhet të kontrollojë çmimet. Unë jam për t'i treguar dhe për t'i imponuar Autoritetit të Konkurrencës të kuptojë rolin mirë, që nuk e keni kuptuar.



*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, jo, nuk e ke kuptuar që objektivi i Autoritetit të Konkurrencës nuk është konkurrenca, por është efienca e tregut. Konkurrenca është procesi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, jo. Ky është gabimi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Prandaj, pra. Ky është problemi i madh që kam unë personalisht edhe me skarcitetin e logjikës në këtë vend. Objektivi nuk është konkurrenca, por është efienca e tregut. Procesi quhet “konkurrencë”...

Si profesor i ekonomisë që jeni do të të jap disa debate cilësore që po zhvillohen aktualisht në Francë për tregun celular, në Itali për tregje të ndryshme, në Gjermani ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju që flisni në emrin e popullit, nuk e keni idenë çfarë ndodh te populli.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E mori përgjigjen.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Spaho, ministrja nuk ka nevojë për avokat. Që në momentin që nuk respektoni rregullat e debatit, që nuk mund të përmbaheni duke ndërprerë, sepse nuk bini dakord me kundërshtarin për mënyrën se si u qaseni gjërave, jeni shembulli më tipik i demonstrimit të arrogancës kundër luftës së arrogancës.

Unë them cilësi debati, ju më kundërshtoni në çdo fjalë.

Ta thashë, kam luftuar fort për këtë gjë, sepse e kam parë në Francë, e kam bërë në Spanjë, e kam parë në Gjermani, e kam parë në dy vende fqinje se si digjitalizimi i proceseve dhe se si sistemi i gjurmueshmërisë *tracke and trace* jepte një panoramë aq të plotë sa që nuk kishte nevojë për debat, se ishte e pastër nëse ishte situatë monopoli ose jo, nëse kishte elemente të kartelit apo jo. Sot marrim një informacion, nesër na japin një informacion tjetër, pasnesër na japin një informacion tjetër. Këtë problem kam unë dhe për këtë hajde të forcojmë dhe të gjejmë instrumentet e duhura për të sjellë jo çdolloj autoriteti, por duhet të kuptojmë edhe rolet e autoritetit.

Unë vetë ende kam paqartësi për disa autoritete, për disa role. Ju e mbani mend debatin e madh që është bërë atëherë me AKU-në, me një institucion shumë të rëndësishëm, ku u

deklarua që kishte rol sigurinë ushqimore, ndërkohë që roli ishte garantimi i sigurisë ushqimore. Fjala “sigurim” me fjalën “garantim” ndryshonte komplet qasjen, qoftë në raport me bizneset private, qoftë me ...

Jemi në një kohë kur duhet të kuptojmë që, siç kemi nevojë ne për t’u edukuar, për të mësuar më shumë, ashtu kanë nevojë edhe bizneset për ta kuptuar, aq më shumë me defektet e një administrate publike.

Gjithsesi, për ta përfunduar debatin, formalizojeni kërkesën që keni.

Kishit diçka, zonja Dhima?

**Antoneta Dhima** - Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, qeveria do të depozitohet në Kuvend aktin normativ në të cilin janë reflektuar të gjitha ndryshimet e paketës të rezistencës sociale dhe ndryshime të tjera. Kryesia e komisionit menjëherë mund të bëjë një kalendar dhe ne të thërrasim të gjithë ministrat sipas atij kalendari për të dhënë shpjegime për të gjitha pyetjet që ka jo vetëm opozita, por edhe pozita.

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** - Shumë faleminderit!

Këtu mbyllet mbledhja e sotme.

Shihemi nesër në orën 10:00.

## **MBYLLET MBLEDHJA**

**Sekretare e komisionit**  
**Enslemvera Zake**

**Përgjegjësjë e Shërbimit të Redaktorëve**  
**Euzheni Pengili**

**Sekretar Administrariv**  
**Elvi Prifti**